

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7925
E enjte, 7 nëntor 2024
Çmimi 0.50 €

Krasniqi ia shpalos
ambasadorit italian
vizionin e PDK-së për
zgjedhjet e 9 shkurtit



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

DONALD TRUMPI FITON ZGJEDHJET PRESIDENCIALE NË SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS (SHBA)

DONALD TRUMPI RIKTHEHET NË SHTËPINË E BARDHË

F. 4-5



Republikani Donald Trump është zgjedhur president i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA). Ai ka mposhtur kundërkandidaten demokrate Kamala Harris, duke

siguruar votat e nevojshme për të shërbyer president edhe për një mandat. Në fjalimin e fitores të mbajtur në Florida, Trumpi është zotuar se do të punojë për ta "shëruar" Amerikën. Po ashtu,

ai është zotuar se do t'i japë fund luftës në Ukrainë dhe në Gaza. Pas fitores Trumpi është uruar nga liderët botërorë, edhe nga liderët e Kosovës dhe të Shqipërisë

OSMANI UDHËTON PËR NË HUNGARI, DO TË MARRË PJESË NË TAKIMIN E KOMUNITETIT POLITIK EVROPIAN

F. 3

BE-ja: TA QUASH 'NON-PAPER' DRAFT-STATUTIN E ASOCIACIONIT ËSHTË SHPËRFFILLJE E OBLIGIMEVE

F. 4

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

SPORT



VAZHDON SHKËLQIMI I ZHEGROVËS, JUVENTUSI MENDON TA KETË NË RADHËT E VETA

F. 10

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Ukraina: Rusia po mbledh dhjetëra mijëra trupa në Kursk

KIEV, 6 NËNTOR - Rusia ka mbledhur rreth 45 mijë trupa në Kursk, si sinjal se mund të jetë duke e përgatitur një kundërofensivë për t'i dëbuar forcat ukrainase nga rajoni, ka thënë komandanti i përgjithshëm ukrainas, gjenerali Oleksandr Syrskiy, më 6 nëntor. Ai ka shtuar se Moska po tenton ta forcojë efektivitetin e saj me ushtarë nga Koreja e Veriut.

Komentet e Syrskiyt në rrjetet sociale erdhën të njëjtën ditë kur Dhoma e Sipërme e Parlamentit të Rusisë, Këshilli i Federatës, ratifikoi një traktat me Phenianin që parashikon ndihmë ushtarake të ndërsjellë, një veprim që ndodhi pasi Uashingtoni konfirmoi dërgimin e 10 000 ushtarëve nga Koreja e Veriut në Rusi. "Armiku



ka grumbulluar rreth 45 000 trupa atje. Dhe po përpqet ta shtojë numrin e tyre. Ushtria ruse vetë nuk është e mjaftueshme në këtë drejtim, prandaj po përpqet të tërheqë personel ushtarak nga Koreja e Veriut", ka shkruar Syrskiy në "Telegram".

Ukraina pretendohet se kontrollon më shumë se 1. 00

kilometra katrorë territor në Kursk pas një ndërhyrjeje të papritur brenda rajonit rus që ka filluar më 6 gusht.

Lëvizja e Kievit ka ardhur si një befasi, pasi forcat e tij të shterura po luftonin në lindje të Ukrainës kundër një ofensivë të ashpër nga forcat ruse, që ishin më të shumta, më të pajisura dhe më të armatosura.

Syrskiy ka thënë se ndërhyrja ishte e nevojshme si një goditje parandaluese kundër një sulmi të mundshëm rus nga Kursku në rajonin ukrainas të Sumyt.

"Për këtë arsye u vendos të zhvillohet një operacion ofensiv parandalues, duke e transferuar luftën në territorin e armikut në rajonin e Kurskut", ka shkruar Syrskiy.

Ai, gjithashtu, ka pretenduar se që nga fillimi i ndërhyrjes së Ukrainës në Kursk janë vrarë 7 905 ushtarë rusë, 12 220 janë plagosur dhe 717 janë kapur.

Shifrat e paraqitura nga Syrskiy nuk janë konfirmuar në mënyrë të pavarur nga "Radio Evropa e Lirë".

Mbrojtja ajrore e Ukrainës ka rrëzuar 38 nga 63 dronët e lëshuar nga Rusia në nëntë

rajone, njoftoi Forca Ajrore në Telegram.

Njëzet e dy dronë të tjerë kanë humbur pasi sistemet e tyre të navigacionit u bllokuan nga njësitë e luftës elektronike ukrainase, shtoi forca ajrore.

Ndërkohë, guvernatori i rajonit juglindor të Zaporizhjas ka thënë se numri i viktimave pas një sulmi me raketë të Rusisë në rajonin e tij kishte arritur në shtatë të vdekur dhe 25 të plagosur.

Rusia ka shtuar sulmet ndaj qyteteve dhe infrastrukturës energjetike të Ukrainës ndërsa po afrohet dimri i tretë në luftë. Ministria e Mbrojtjes e Rusisë, ndërkohë, tha se mbrojtja e saj ajrore rrëzoi tre dronë ukrainas mbi rajonet e Kurskut dhe Oryolit.

"Shërbimi i ri ushtarak" gjerman sipas ligjit të ri, ja ku do të jetë fokusi

BERLIN, 6 NËNTOR - Forcat e armatosura gjermane do të rriten dhe kanë nevojë për formë shtesë të rekrutimit. Projektligji i ministrit të Mbrojtjes, Pistorius fokusohet në shërbimin vullnetar. Ministria gjermane e Mbrojtjes me një projektligj po hedh themelet për futjen e një shërbimi të ri ushtarak në Gjermani. Ministri i Mbrojtjes, Boris Pistorius shpreson se Kabineti Federal do të miratojë planet e tij, të cilat duhet të eliminojnë një pengesë të madhe.

Pse është i nevojshëm një model i ri i shërbimit ushtarak?

Duke pasur parasysh ndryshimin e situatës së kërcënimit, Forcat e armatosura gjermane, Bundeswehri duhet të shtohen në numër. Nga njëra anë bëhet fjalë për numrin e ushtarëve aktivë. Në vitet në vijim, numri i tyre do të rritet nga rreth 180 000 në rreth 200 000. Do të nevojiten gjithashtu më shumë rezervistë. Që nga pezullimi i rekrutimit në vitin 2011, Bundeswehr-i i është drejtuar rekrutimit të

vullnetarëve, për shembull përmes qendrave të karrierës së forcave të armatosura.

Deri sot çdo vit kanë dalë vullnetarë për shërbimin ushtarak rreth 10.000 të rinj dhe të reja. Kjo mundësi do të vazhdojë të ekzistojë. Megjithatë, nuk do të mjaftojë për të zgjidhur problemet e personelit të trupave.

Si funksionon modeli i ri?

Kur të arrijnë moshën e shërbimit ushtarak, pra zakonisht 18 vjeç, të rinjtë dhe të rejat do të marrin një letër me një kod QR që përmban një pyetësor në internet nga Bundeswehri. Meshkujt kanë detyrim ta plotësojnë pyetësorin. Nëse nuk e bëjnë këtë edhe pasi iu kërkohet një gjë e tillë, ata përballen me gjobë. Për femrat, pjesëmarrja është vullnetare. Supozohet të ketë vetëm disa pyetje. Planifikuesit llogarisin që duhen rreth 15 minuta për ta përfunduar.

Ndër të tjera, pyetësi pyet për aftësinë fizike dhe gatishmërinë e përgjithshme për të kryer shërbimin ushtarak. Më pas Bundeswehri shqyrton pyetësorët, bën një përzgjedhje



dhe fton kandidatët për shërbimin e detyrueshëm ushtarak. Në vitin e parë do të rekrutohen për shërbimin ushtarak 5000 kandidatë. Sipas Ministrisë Federale të Mbrojtjes, aftësitë stërvitore të Bundeswehrit aktualisht nuk janë të mjaftueshme për më shumë rekrutë.

Pse është i detyrueshëm vetëm për meshkujt?

Ish-shërbimi i detyrueshëm ushtarak, i pezulluar, zbatohet vetëm për meshkujt. Kjo nuk duket e përshtatshme sot. Shumë femra janë të interesuara të shërbejnë në Bundeswehr. Ministria Federale e Mbrojtjes po

studion nëse detyrimi për plotësimin e pyetësorit në shërbimin e ri të detyrueshëm ushtarak mund të zbatohet edhe për femrat. Ekspertët besojnë se kjo do të kërkonte ndryshimin e kushtetutës, Ligjit Bazë. Për momentin, qeveria gjermane nuk dëshiron ta trajtojë këtë çështje. Prandaj, pjesëmarrja e femrave ende nuk është e detyrueshme.

Ç'pamje do të ketë konkretisht shërbimi ushtarak?

Do të fillonte me gjashtë muaj shërbim të ashtuquajtur bazë. Më pas, ekziston mundësia për ta zgatur atë deri në 23 muaj. Nëse

shërbimi zgjat përtej gjashtë muajve të parë, ai mund të lidhet me stimuj të tillë si marrja e një lejeje drejtimi të posaçme të automjeteve ose të llogaritit koha e periudhës së shërbimit ushtarak në pritjen për një vend studimi në universitet. Paga bazë pritet të jetë rreth 1800 euro në muaj.

A mund ta zgjidhë "shërbimi i ri ushtarak" problemin e rekrutimit?

Nëse Dhoma e Landeve, Bundesrati dhe Bundestagu i japin ligjit dritën të gjelbër, ai ndoshta mund të hyjë në fuqi pranverën e ardhshme. Duket realiste që 5 000 vendet e planifikuara të plotësohen plotësisht me vullnetarë në vitin e parë. Megjithatë, planet e Bundeswehrit parashikojnë një rritje të numrit të kuotave të shërbimit ushtarak në vitet në vijim. Është e pasigurt nëse ky objektiv mund të arrihet vetëm me parimin e shërbimit vullnetar. Prandaj, nuk përjashtohet që të nevojiten të bëhen ndryshime në shërbimin ushtarak, për ta bërë atë shumë më të detyrueshëm. /DW

Zvicra ndalon mbulimin e fytyrës në hapësira publike nga janari

Bernë, 6 nëntor - Një vendim kontrovers i Zvicrës për ndalimin e mbulimit të fytyrës në hapësira publike, i njohur gjerësisht si "ndalimi i burkave", do të hyjë në fuqi më 1 janar të 2025-s, ka thënë qeveria zvicerane të mërkurën.

Ky ndalim, që ka kaluar me një dallim të vogël votash në një

referendum të vitit 2021 dhe që është dënuar nga shoqatat myslimane është iniciuar nga i njëjti grup që kishte organizuar ndalimin e minareve të reja në vitin 2009. Këshilli Federal qeverisës ka thënë në një deklaratë se ka vendosur datën e fillimit të ndalimit dhe se kushdo që do ta shkelë atë pa të drejtë do të

përballet me një gjobë deri në 1 000 franga zvicerane.

Ndalimi nuk vlen për avionë ose për ambiente diplomatike dhe konsullore, ndërsa fytyrat mund të mbulohen edhe në vendet e adhurimit dhe vende të tjera të shenjta, tha qeveria. Mbulimi i fytyrës do të mbetet i lejuar për arsye të shëndetit dhe sigurisë, për zakone

vendase ose për kushte moti, është thënë në deklaratë. Gjithashtu, mbulesa do të lejohet për arsye artistike dhe argëtimi, si dhe për reklamim. Nëse këto mbulime janë të nevojshme për mbrojtje personale në ushtrimin e lirisë së shprehjes dhe të bashkimit, ato duhet të lejohen nëse autoriteti përgjegjës e ka



miratuar tashmë dhe nuk dëmtohet rendi publik, është thënë në deklaratën e Këshillit Federal të Zvicrës.

Buja: UÇK-ja s'ka pasur hetuesi ose organe të drejtësisë

HAGË, 6 NËNTOR - Dëshmitari dhe ish-komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Shukri Buja, ka deklaruar në Hagë se në rast që kanë ndodhur sjellje joadekuade të ushtarëve ndaj civilëve, nuk ka pasur organe të hetuesisë në UÇK ose gjykata për t'u marrë me çështje të tilla. "Ndonjë masë disiplinore mund të jetë trajtuar, por për shkelje të tjera nuk kemi pasur asnjë kompetencë si zonë operative e luftës. S'kemi pasur mekanizma, s'ka pasur gjykatë, s'ka pasur hetuesi ose organe të drejtësisë. Unë e potencova atë rregulloren dhe nëse ka pasur shkelje disiplinore, ne kemi mundur të marrim masa deri në atë shkallë sa ka qenë mundësia



rregullative për të marrë masa si komandë e zonës", ka thënë Buja. Kjo deklaratë e ish-komandantit

Buja ka ardhur pasi prokurori James Pace e ka pyetur atë se a e di nëse ndonjë ushtar i UÇK-së në Zonën e Nerodimes të jetë

hetuar nga UÇK-ja për mënyrën se si e ka trajtuar ndonjë civil, raporton "Betimi për Drejtësi". "S'kemi pasur mekanizma për formë të tillë. Bindja ime ka qenë që civilët të trajtohen në mënyrën më të mirë të mundshme. Duhet ta keni parasysh se ne në atë kohë kemi bërë luftë të ashpër për fitimin e simpatisë brenda popullit tonë për ta krijuar simpatinë e faktorit ndërkombëtar, dhe çdo veprim yni në drejtim të civilëve, që mund ta krijonte përshtypjen e veprimit kriminal apo terrorist, na dëmtonte si UÇK. Hetimet për ndonjë ushtar kanë mundur të ndodhin pas luftës. unë e kam këtë bindje", ka thënë Buja.

Më tutje, Buja është pyetur nëse UÇK-ja ka hetuar ose shqiptuar ndonjë dënim në rastet e keqtrajtimeve që ka mundur të ndodhnin gjatë luftës. "Unë nuk besoj që kanë mundur të hetojnë sepse nuk ka pasur mekanizëm për të hetuar...", ka thënë Buja, duke përmendur se nuk kanë pasur gjykatë e as hetuesi.

Me qaq kanë përfunduar pyetjet e ZPS-së për Bujën, por kanë vazhduar diskutimet për pranimin e provave materiale. Shukri Buja për disa ditë më radhë ka dëshmuar në Gjykatën Speciale në procesin gjyqësor ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

BE-ja: Ta quash 'non-paper' draft-statutin e Asociacionit është shpërfillje e obligimeve

BRUKSEL, 6 NËNTOR - Kosova nuk mund t'u ikë përgjegjësisë të veta nga dialogu i Brukselit dhe cilësimi i draftstatutit evropian për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe si "non-paper" nga zyrtarët e saj, tregon mungesë respekti për obligimet e saj nga dialogu, ka thënë zëdhënësi i Bashkimit Evropian (BE), Peter Stano. "Ta quash draftstatutin evropian thjesht një 'non-paper', paraqet mospërfillje të ftesës së Këshillit të Bashkimit Evropian që të veprohet në bazë të tij pa vonesa të reja drejt themelimit të Asociacionit", ka thënë Stano.

Në tetor 2023, BE-ja ua ka dorëzuar Kosovës dhe Serbisë një "draft-statut modern" për formimin e Asociacionit. Shtetet e Bashkuara, Gjermania, Franca dhe Italia e kanë mbështetur atë. Prej atëherë, Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian i kanë bërë thirrje vazhdimisht Kosovës ta dërgojë në Gjykatën Kushtuese këtë draftstatut.

Zyrtarët e qeverisë së kryeministrit Albin Kurti edhe në të kaluarën e kanë cilësuar si "non-paper" draftstatutin evropian. Por, disa ditë pasi Kurti ka thënë se ai si kryeministër nuk mund të themelojë asociacione

komunash, zëdhënësi i tij, Përparim Kryeziu, ka thënë për medie vendëse më 1 nëntor se draftstatuti evropian "është ai i një non-paperi", dhe se kryeministri nuk e ka pranuar atë.

Në gjuhën e institucioneve evropiane, "non-paper" është një dokument joformal, i cili ekspozohet në negociata të mbyllura brenda institucioneve të BE-së, në përpjekje për të gjetur marrëveshje për ndonjë çështje të kontestuar. Megjithatë, Stano ka ngulur këmbë se Kurti dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, e kanë pranuar këtë draftstatus në parim vitin e kaluar, kur i dërguari i posaçëm i BE-së për dialogun, Miroslav Lajçak, ua ka paraqitur në prani të liderëve evropianë, presidentit francez Emmanuel Macron, kryeministres italiane Giorgia Meloni dhe kancelarit gjerman Olaf Scholz. "Në konkluzionet e dhjetorit të vitit 2023, Këshilli Evropian mirëpriti gatishmërinë e Serbisë dhe të Kosovës për ta pranuar draftstatutin e propozuar palëve nga ana e lehtësuesit të BE-së. Kjo paraqet pranim formal të dokumentit nga të gjithë 27 vendet anëtare", ka thënë Stano.

Ai ka theksuar se blloku ndien keqardhje që "pavarësisht pranimit të dokumentit", nuk është arritur përparim drejt themelimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në përputhje me draftstatutin evropian. "Në përputhje me ripërkushtimin zyrtar ndaj dialogut dhe implementimit të plotë të të gjitha marrëveshjeve, ne kërkojmë nga Kosova që të ecë përpara pa vonesa të reja", ka thënë ai.

Kosova dhe Serbia fillimisht arritën marrëveshje për formimin e Asociacionit më 2013 dhe një tjetër marrëveshje për parimet më 2015. Por, Qeveria e Kosovës refuzon të formojë, siç thotë, asociacion njëetnik, ndërsa Serbia insiston për zbatimin e marrëveshjes. Më 2015, Gjykata Kushtuese e Kosovës ka vlerësuar se marrëveshja për parimet nuk është në përputhje me Kushtetutën në 23 pika të saj, ndonëse ato mund të harmonizohen.

Stano ka theksuar se, megjithëse kanë kaluar 11 vjet nga marrëveshja e parë, Kosova ende nuk i ka ndërmarrë "hapat e nevojshëm" drejt themelimit të tij dhe "prandaj nuk është duke



përmbushur obligimet e qarta sipas së drejtës ndërkombëtare". Ai ka thënë se Qeveria e Kosovës nuk mund të heqë dorë nga barra e përgjegjësisë që burojnë nga dialogu dhe se themelimin e Asociacionit nuk mund t'u lë në dorë komunave. "Çfarëdo propozimi duhet të diskutohet me Serbinë dhe lehtësuesin e BE-së dhe duhet të jetë në përputhje me marrëveshjet e viteve 2013 dhe 2015. Kjo, po ashtu, do të thotë se Qeveria e Kosovës nuk mund ta përpilojë statutin jashtë procesit të dialogut", ka thënë Stano.

Ditë më parë zëdhënësjë e

Bashkimit Evropian, Nabila Massrali, i ka thënë "Radios Evropa e Lirë" se themelimi i Asociacionit është obligim ligjor për Kosovën sipas të drejtës ndërkombëtare. Sipas saj, fakti që marrëveshjet për Asociacionin janë arritur në kuadër të dialogut, "nënkupton që secili propozim duhet të diskutohet me Serbinë dhe ndërmjetësuesin e BE-së". Edhe në Raportin e Progresit të BE-së për Kosovën mungesa e hapave drejt themelimit të Asociacionit është përmendur si pengesë në procesin e normalizimit mes vendeve fqinje.

Osmani udhëton për në Hungari, do të marrë pjesë në takimin e Komunitetit Politik Evropian

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka udhëtuar për në Hungari. Ajo do ta përfaqësojë Republikën e Kosovës në samitin e pestë të Komunitetit Politik Evropian (EPC). Takimi i radhës i Komunitetit Politik Evropian do të mbledhë liderë nga 47 shtete nga i gjithë kontinenti, në Budapest. Në këtë samit

presidentja Osmani bashkë me liderët e tjerë do të diskutojnë mbi sfidat e sigurisë në Evropë, të shkaktuara nga lufta në Ukrainë, për përshkallëzimin e krizës në Lindjen e Mesme, për sfidat e migracionit dhe ato ekonomike.

Presidentja Osmani do të marrë pjesë në dy sesionet plenare të EPC-së si dhe do të



mbajë dy fjalime, njërin në seancë plenare, tjetrin në tryezën punuese për sigurinë

ekonomike. Në kuadër të samitit, presidentja Osmani do të zhvillojë takime bilaterale me liderët e tjerë evropianë. Gjatë qëndrimit në Budapest, Osmani pritet të zhvillojë një takim edhe me mërgatën shqiptare në Hungari. Komuniteti Politik Evropian është një platformë për liderët evropianë për të diskutuar

çështjet kyçe me të cilat përballet kontinenti, nga siguria dhe migrimi te stabiliteti ekonomik dhe mjedisi. E nisur në vitin 2022, EPC-ja synon t'i forcojë lidhjet politike dhe ekonomike në të gjithë Evropën, të ofrojë zgjidhje për sfidat e përbashkëta dhe ta thellojë bashkëpunimin midis vendeve të BE-së dhe jashtë saj.



DONALD TRUMPI FITON ZGJEDHJET PRESIDENCIALE NË SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS (SHBA)

Donald Trumpi rikthehet në Shtëpinë e Bardhë

Republikani Donald Trump është zgjedhur president i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA). Ai ka mposhtur kundërkandidaten demokrate Kamala Harris, duke siguruar votat e nevojshme për të shërbyer president edhe për një mandat. Në fjalimin e fitores të mbajtur në Florida, Trumpi është zotuar se do të punojë për ta “shëruar” Amerikën. Po ashtu, ai është zotuar se do t’i japë fund luftës në Ukrainë dhe në Gaza. Pas fitores Trumpi është uruar nga liderët botërorë, edhe nga liderët e Kosovës dhe të Shqipërisë

EPOKA E RE

Lirim GECI

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Donald Trump, kandidat i republikanëve dhe ish-president, është shpallur presidenti i 47-të i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ai ka garuar kundër demokrates Kamala Harris, aktualisht nënpresidente amerikane, në zgjedhjet e mbajtura të martën. Trumpi ka fituar në shumicën e atyre që njihen si shtete të papërcaktuara, duke siguruar 277 vota të Kolegjit Elektoral. Një kandidat duhet të fitojë të paktën 270 vota për

t'u shpallur fitues. Fitorja e tij është konfirmuar pasi ka triumfuar në katër shtete të papërcaktuara: Pensilvani, Uiskonsin, Karolinë të Veriut dhe Xhorxhia. Vetë Trumpi u është drejtuar mbështetësve nga Florida të mërkurën ku është zotuar se do të punojë për ta “shëruar” Amerikën. Duke iu referuar fitores, Trumpi ka thënë para mbështetësve se kjo ka qenë lëvizja më e madhe politike në historinë amerikane. “Amerika na ka dhënë një mandat të pashembullt dhe të fuqishëm”, ka thënë Trumpi, si referencë për fitoren e republikanëve në

Senat, i cili deri më tani është kontrolluar nga Partia Demokratike.

Më tutje, Trumpi, i cili do ta marrë detyrën më 20 janar të vitit 2025, ka deklaruar se ai do t’i “ndalojë luftërat”. Duke iu referuar presidencës së tij të mëparshme, ai ka pohuar se “nuk kemi pasur luftëra, për katër vjet nuk kemi pasur luftëra, përveçse kemi mundur ISIS-in”. “Ata thanë, ai do të fillojë një luftë. Unë nuk do të filloj një luftë. Unë do t’i ndaloj luftërat”, ka thënë ai.

Shqipëria dhe Kosova përgëzojnë Trumpin për rikthimin në Shtëpinë e Bardhë

Fitorja historike e Donald Trumpit është komentuar anëmbanë botës, edhe në Kosovë dhe Shqipëri. Udhëheqësit e Shqipërisë dhe të Kosovës kanë shprehur shpresën për vazhdimin dhe thellimin e bashkëpunimit me Shtetet e Bashkuara, pasi Trumpi ka shpallur fitoren në

zgjedhjet e së martës.

Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, duke e uruar Trumpin për fitoren, ka theksuar se pret që ta forcojë edhe më tutje bashkëpunimin me ShBA-në.

Kurse kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, e ka përgëzuar Trumpin për fitoren, duke thënë se “ka qenë nder të punoj me ju sa keni qenë president për t’i forcuar lidhjet në mes të të dyja shteteve. Do të kem privilegjin të punoj me ju si presidenti i 47-të, për ta rritur partneritetin për paqe, begati dhe përparim të mëtejshëm”. Edhe presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, duke përgëzuar Donald Trumpin për fitoren, ka thënë se mezi pret të bashkëpunojë me presidentin e ri amerikan. “Shtetet e Bashkuara mbeten partner i palëkundur dhe aleat i domosdoshëm i Kosovës. Mezi pres të punoj me administratën e re për të thelluar më tej lidhjen tonë të veçantë dhe aleancën strategjike. Zoti e bekoftë

Amerikën, udhëheqësen e botës së lirë!”, ka shkruar Osmani në rrjetet sociale.

Edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e ka uruar Trumpin për fitoren, duke theksuar se “Shtetet e Bashkuara janë një aleat kryesor, mik dhe partner i Kosovës dhe mezi presim të punojmë së bashku për përparim dhe paqe”.

Krahas liderëve institucionalë të Kosovës, Trumpi është uruar edhe nga drejtuesit e partive politike. Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, e ka uruar Donald Trumpin për fitoren në zgjedhjet në ShBA. Ai ka thënë se fitorja e Trumpit është dëshmi e forcës së demokracisë amerikane.

Fitoren Trumpit ia ka uruar edhe kandidati i PDK-së për kryeministër, Bedri Hamza, lideri i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ai i AAK-së, Ramush Haradinaj, lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj dhe presidenti i AKR-së, Behgjet Pacolli, i cili ka qenë pjesë e festës së presidentit të ri amerikan.

Udhëheqës botërorë përgëzojnë Trumpin për fitoren

Udhëheqës nga e gjithë bota e kanë përgëzuar të mërkurën Donald Trumpin për fitoren në zgjedhjet presidenciale amerikane.

Kryeministri britanik Keir Starmer, pasi e ka uruar Trumpin për fitoren, ka thënë se “mezi pres të punoj me ju në vitet në vijim”. “Unë e di se marrëdhënia e posaçme ndërmjet Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara do të vazhdojë të përparojë në të dyja anët e Atlantikut për vitet në vijim”, ka thënë

Starmer, duke nënvizuar se “si aleatët më të afërt, ne qëndrojmë krah për krah në mbrojtje të vlerave tona të përbashkëta të lirisë dhe demokracisë”.

Ndërsa presidenti francez Emmanuel Macron e ka uruar Trumpin duke theksuar se është i gatshëm të punojë me të për më shumë paqe dhe begati në botë.

Në anën tjetër, kancelari gjerman Olaf Scholz, duke e uruar presidentin Trump, ka thënë se “Gjermania dhe Shtetet e Bashkuara kanë punuar së bashku me sukses për një kohë të gjatë për ta nxitur përparimin dhe lirinë në të dyja anët e Atlantikut. Ne do të vazhdojmë ta bëjmë këtë për të mirën e qytetarëve tanë”.

Në anën tjetër, kryeministria italiane Giorgia Meloni, në urimin e saj për Trumpin, ka thënë se Italia dhe Shtetet e Bashkuara kanë një “aleancë të palëkundur”. “Është një lidhje strategjike, të cilën jam e sigurt se tani do ta forcojmë edhe më tej”, ka thënë Meloni. Edhe sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, ka uruar

Trumpin për fitoren, duke theksuar se “udhëheqja e tij do të jetë përsëri thelbësore për ta mbajtur të fortë aleancën tonë”. “Mezi pres të punoj përsëri me të për ta avancuar paqen përmes NATO-s”, ka thënë Rutte.

Urimi për Trumpin nuk ka munguar as nga presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, e cila ka thënë Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara janë “më shumë se thjesht aleatë”.

“Ne jemi të lidhur nga një partneritet i vërtetë mes njerëzve tanë, duke bashkuar 800 milionë qytetarë. Pra, le të punojmë së bashku për një agjendë të fortë transatlantike...”, ka shkruar ajo në platformën “X”.

Më tutje, kryeministri spanjoll i krahut të majtë, Pedro Sanchez, është zotuar të punojë për partneritetin ndërmjet dy vendeve. “Urime për fitoren tuaj dhe zgjedhjen tuaj presidenti i 47-të i ShBA-së! Ne do të punojmë për marrëdhëniet tona strategjike dypalëshe dhe në një partneritet të fortë transatlantik”, ka shkruar kryeministri Sanchez në “X”.

Edhe presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky e ka përgëzuar Trumpin për atë që e quajti një fitore “mbresëlënëse”. “Unë e çmoj angazhimin e presidentit Trump për qasjen ‘paqe përmes forcës’ në çështjet globale. Ky është pikërisht parimi që praktikisht mund të sjellë më afër paqen në Ukrainë”, ka shkruar presidenti Zelensky në “X”.

Edhe kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu e ka përgëzuar Trumpin për “rikthimin më të madh ndonjëherë”. “Rikthimi juaj historik në Shtëpinë e Bardhë mundëson një fillim të ri për Amerikën dhe një përkushtim



të ri të madh për aleancën e mrekullueshme mes Izraelit dhe Amerikës. Kjo është fitore e madhe!”, ka theksuar Netanyahu.

Urimet për Trumpin nuk kanë munguar as nga presidenti i Turqisë, Rexhep Taip Erdogan. Ai ka thënë se shpreson që “marrëdhëniet Turqi - ShBA do të forcohen, se krizat dhe luftërat rajonale dhe globale, veçanërisht çështja palestineze dhe lufta Rusi - Ukrainë, do të marrin fund”.

Kryeministri indian Narendra Modi gjithashtu e ka përshëndetur fitoren e Trumpit, duke e cilësuar “historike”. Ai ka shkruar në rrjetet sociale se mezi pret ta ripërtërijë bashkëpunimin ndërmjet dy vendeve. “Së bashku le të punojmë për përmirësimin e popujve tonë dhe për t’i promovuar paqen, qëndrueshmërinë dhe prosperitetin global”, ka thënë Modi.

Kremlini ka thënë se do ta

gjykojë Donald Trumpin për veprimet e tij. “Ne do të nxjerrim përfundime bazuar në hapat konkretë dhe fjalët konkrete”, u ka thënë gazetarëve zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, duke shtuar se ai “nuk ishte në dijeni të planeve se presidenti rus Vladimir Putin do ta urojë zotin Trump”, pasi ShBA-ja është një “vend jomiqësor”.

Grenelli: Radha juaj Hashim Thaçi

Ish-emisari për Ballkanin, Richard Grenell, i cili nga të gjitha mediet në ShBA po përfillet se do të jetë pjesë e rëndësishme e kabinetit të Trumpit, kishte reaguuar pasi ky i fundit e pati fituar betejën me prokurorin Jack Smith.

Gjykata në Amerikë kishte vlerësuar se emërimi i Smithit

kishte qenë antikushtetues. Grenelli kishte thënë se radha është e Hashim Thaçit, duke aluduar në lirinë e tij. “Rasti i Jack Smith kundër Trumpit po shembet. Radha është te ti, Hashim Thaçi”, kishte shkruar Grenelli në “X”.

Madje Grenelli kishte thënë se mezi pret që Trumpi ta lirojë ish-presidentin Hashim Thaçi nga burgu. “Çfarë unë besoj, është që kur ne ishim duke bërë progres, Jack Smith ishte në Hagë atëkohë, targetoi presidentin Thaçi. Tani presidenti Thaçi vazhdon të jetë në burg dhe kjo është një mizori. Për mua është një mizori. S’ndihem mirë për një situatë të tillë, sepse ne e ftuam të vijë në ShBA të negociojë dhe ai u penalizua dhe shkoi në burg për këtë. Unë e ndiej që duhet të bëjë diçka që ta nxjerr nga burgu dhe kam provuar dhe mezi pres që presidenti Trump të fitojë, sepse do ta nxjerrim Thaçin nga burgun”, kishte thënë Grenelli.



Dy shkolla profesionale në Skenderaj pajisen me makina për qepje

SKENDERAJ, 6 NËNTOR - Në kuadër të projektit "Reload 2", i financuar nga UNDP-ja dhe komuna e Skenderajt, dy shkollat e mesme të qytetit - Qendra e Kompetencës dhe Institucioni për Arsim dhe Aftësim Profesional "Anton Çetta" - janë pajisur me nga 6 makina për qepje, përfshirë elementet përcjellëse, të cilat do të shërbejnë për punën

praktike në profilet e dizajnit. Drejtoresha për Zhvillim Ekonomik, Ndërmarrësi, Inovacion dhe Turizëm, Besarta Meha-Ademi, është shprehur e lumtur që nëpërmjet projektit të përbashkët në mes të komunës dhe UNDP-së po ndihmohen institucionet arsimore për punën e tyre

praktike. "Ky është projekti i radhës përmes të cilit po përfitojnë jo vetëm shkollat e komunës sonë, por edhe komuniteti sportiv, respektivisht Klubi i Volejbollit Skenderaj (F) i cili ka përmirësuar kushtet e aktivitetit sportiv. Ky projekt është implementuar nga OJQ "Initiative Qytetare Skenderaj", ka njoftuar



Protestë në mbështetje të punëtorëve teknike në Kuvend



PRISHTINË, 6 NËNTOR - Kolektivi Feminist dhe organizata "Përpjekja" kanë mbajtur protestë solidarizuese me grevën e punëtorëve teknike të Kuvendit të Kosovës. Ato kanë mbajtur pankarta në duar me mbishkrimet: "Punëtorët nuk janë mall", "Pagë të njëjtë për punë të njëjtë", "Schafberger shtyp punëtorët, Kuvendi e lejon" etj. Yll Islami nga organizata "Përpjekja" ka thënë se këto grati janë në javën e tetë të grevës dhe se kërkesat i kanë të qarta dhe të drejta. Ai ka theksuar se kompania "Schafberger", e cila e ka fituar tenderin për mirëmbajtjen e Kuvendit, ofertën më të lirë e ka ofruar në kurriz të punëtorëve të cilat i paguan vetëm 275 euro në muaj

pagë kjo që, sipas tij, në shumë raste nuk e mbulon as qiranë e banesës në Prishtinë. Islami ka theksuar se do të vazhdojnë aktivitetet derisa këtyre punëtorëve t'u plotësohen kërkesat. "Kompania Schafberger e cila e ka fituar tenderin për mirëmbajtjen e Kuvendit, ofertën më të lirë e ka ofruar në kurriz të punëtorëve të cilat i paguan vetëm 275 euro në muaj, pagë kjo që në shumë raste nuk e mbulon as qiranë e banesës në Prishtinë. Prandaj kur jepen tenderë nga shteti, në kontrata duhet të përfshihen edhe pagat e punëtorëve dhe kushtet e punës", ka thënë ai, duke paralajmëruar edhe aktivitetet e tjera në mbështetje të punëtorëve teknike të Kuvendit.

Vihet gurthemeli i objektit të AMF-së në Uglar të Gjilanit



GJILAN, 6 NËNTOR - Është vënë gurthemeli për ndërtimin e Ambulantes së Mjekësisë Familjare (AMF) në fshatin Uglar të Gjilanit, e cila, përpos që do të ofrojë shërbime cilësore për banorët e këtij lokaliteti, do të ketë edhe infrastrukturë moderne. Në këtë ngjarje ishin edhe disa deputetë nga Kuvendi i Kosovës, ata nga KK Gjilan, drejtorë, zyrtarë të tjerë komunalë e shëndetësorë dhe përfaqësues të fshatit. Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka thënë se ndërtimi i Ambulantes së Mjekësisë Familjare në Uglar po bëhet me qëllim për t'i

përbushur nevojat e banorëve të këtij lokaliteti me shërbime mjekësore. Ai ka thënë se shpreson se punët do të kryhen mirë dhe shpejt. "Së bashku me deputetë, asamblistë dhe drejtorë, vumë gurthemelin e AMF-së në Uglar", ka thënë Hyseni. Sipas tij, infrastruktura e re dhe moderne, me një hapësirë prej 180 metrash katrorë dhe në vlerë prej rreth 130 000 eurosh, do të ofrojë shërbime cilësore dhe lehtësisht të qasshme për banorët. "Java e shëndetësisë sapo ka filluar. Na presin edhe shumë lajme të reja deri të premtën", ka thënë Hyseni.

QKMF-ja e Drenasit edhe të shtunave ofron shërbime laboratorike

DRENAS, 6 NËNTOR - Drejtorja për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (FShMS) në Drenas është duke vazhduar me përkushtim krijimin e kushteve më të mira për shërbime cilësore në sektorin e shëndetësisë, duke e vendosur mirëqenien sociale si prioritet për

përmirësimin e kujdesit ndaj qytetarëve. Kjo drejtori i ka njoftuar qytetarët e komunës së Drenasit se nga muaji nëntor i këtij viti shërbimi laboratorik në QKMF "Dr. Hafir Shala" do të jetë i hapur edhe të shtunave për t'i përbushur më mirë

nevojat shëndetësore të qytetarëve. Drejtoresha e DShMS-së, Lumnije Krapit, ka theksuar se këto ndryshime janë pjesë e angazhimit për t'i përmirësuar shërbimet shëndetësore dhe për t'i përbushur më mirë kërkesat e qytetarëve.



Haradinaj në Rahovec nderon disa prej heronjve të '98-s

RAHOVEC, 6 NËNTOR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka bërë homazhe para pllakës së vendosur për heronjtë Xhelal Hajda-Toni, Selajdin Mullabazi-Mici, Bektesh Haliti, Hamdi Hajrizi dhe Nezir Ymeri, të cilët kanë rënë heroikisht në luftën e fundit në Rahovec.

Haradinaj ka shkruar në "Facebook" se "heroizmi i tyre është drita jonë udhërrëfyese". "Xhelal Hajda-Toni, Selajdin Mullabazi-Mici, Bektesh Haliti, Hamdi Hajrizi dhe Nezir Ymeri, emra që do të jehojnë përgjithmonë në historinë tonë. Sakrifika e tyre sublimë na frymëzon çdo ditë për të

çuar përpara idealet e lirisë dhe pavarësisë. Këta trima na mësojnë se dashuria për atdheun është më e fortë se çdo sfidë. Sot i shoqëruar nga kryetari Smajl Latifi e shumë bashkëpunëtorë, nderuam guximin e tyre të pashembullt që mbetet frymëzim për brezat që vijnë", ka shkruar Haradinaj.



Krasniqi ia shpalos ambasadorit italian vizionin e PDK-së për zgjedhjet e 9 shkurtit



PRISHTINË, 6 NËNTOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka pritur të mërkurën në takim ambasadorin e Italisë në Prishtinë, Antonello De Riu. Krasniqi ka bërë me dije se me ambasadorin italian kanë biseduar për zgjedhjet e 9 shkurtit të vitit 2025, vizionin dhe programin e PDK-së. Në këtë kontekst, Krasniqi ka thënë se Bedri Hamza si kryeministër i ardhshëm i Kosovës do të angazhohet për forcimin e raporteve me Italinë. "Pata kënaqësinë, të pres në selinë e Partisë Demokratike të Kosovës ambasadorin e Italisë në Kosovë, Antonello De Riu,

me të cilin diskutuam rreth zhvillimeve aktuale politike në vend. Në këtë takim, folëm edhe për vizionin dhe programin e PDK-së për zgjedhjet nacionale. Kosovës i duhet një qeveri që i ruan raportet e mira me aleatët dhe synon integrimin evropian dhe anëtarësimin në organizata ndërkombëtare. Ambasadorin De Riu e falënderova për mbështetjen e vazhdueshme që Italia i ka dhënë Kosovës, duke u zotuar se qeveria e re me Bedri Hamzën kryeministër do të angazhohet në thellimin e këtij bashkëpunimi", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

Rama thotë se e ka përkrahjen e Abdixhikut që të kandidojë edhe për një mandat për kryetar të Prishtinës



PRISHTINË, 6 NËNTOR - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë me dije për medie se e ka përkrahjen e kryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, që të jetë kandidat edhe për një mandat për kryetar të kryeqytetit. Ai këto deklarata i ka bërë pas nisjes së punimeve për projektin "Ndërtimi i Ishullit Urban Arbëri - Pallati i Rinisë". I pyetur nga gazetarët lidhur me raportet e tij me kryetarin e

LDK-së, Rama ka thënë se çdoherë kanë pasur marrëdhënie të mira me të, dhe se ky raport, sipas tij, është duke vazhduar. "Ne kemi pasur marrëdhënie të mira. Secili punën e vet, unë si kryetar i kryeqytetit me projekte të mëdha në transformim të kryeqytetit, Lumiri me punët e veta me LDK, që ta dërgojë përpara aspektin e programeve. Ju e dini që kemi garuar së bashku, e kemi programin e njëjtë të transformimit të kryeqytetit.

Patjetër që po", ka thënë ai. Më tutje, Rama u ka bërë thirrje partive opozitare ta votojnë buxhetin e Prishtinës për vitin 2025 pasi, sipas tij, janë duke bllokuar transformimin e kryeqytetit. "I bëj thirrje opozitës të jetë konstruktive dhe jo destruktive. Nuk ka asnjë arsye që asamblistët e opozitës ta komprometojnë zhvillimin dhe transformimin e kryeqytetit nëpërmjet bllokadave të ndryshme sikurse është mosvotimi i buxhetit", ka thënë Rama.

Haxhiu viziton Akademinë e Drejtësisë në Turqi

ANKARA, 6 NËNTOR - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka vizituar Akademinë e Drejtësisë gjatë vizitës zyrtare në Ankara të Turqisë. Haxhiu është njoftuar nga afër për zhvillimin e trajnimeve dhe programeve edukative në Turqi të cilat ofrohen nga ky institucion. Në një postim të Ministrisë së Drejtësisë në "Facebook" është

bërë me dije se Haxhiu ka folur për reformat që po implementohen nga Ministria e Drejtësisë në raport me Akademinë e Drejtësisë, përmes të cilave po synohet të krijohet një sistem dinamik dhe i strukturuar mirë i trajnimeve që do të ofrojë mundësi për zhvillimin e aftësive praktike dhe teorike për profesionistët e drejtësisë në përputhje me

standardet ndërkombëtare. Më tutje, ministrja Haxhiu ka thënë se shtimi i bashkëpunimit në mes të Kosovës dhe Turqisë dhe shkëmbimi i përvojave mes dy shteteve do ta rrisin efikasitetin dhe transparencën në sistemin e drejtësisë dhe do ta forcojnë besimin e qytetarëve në raport me sistemin e drejtësisë në vend.



Dogana e Kosovës thyen rekordin e të hyrave

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Fillimi i muajit nëntor shënoi një arritje historike për Doganën e Kosovës, pas mbledhjes së mbi 1.5 miliard eurove të hyra. Kjo shifër përfaqëson një rritje mbresëlënëse prej 10.5-përqindësh krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Gjatë njëmbëdhjetë muajve të parë të vitit 2023 të hyrat e mbledhura ishin 1.36 miliard euro, ndërsa këtë vit shuma

është rritur për 146.1 milionë euro. Ky trend pozitiv, i nisur vitin e kaluar, ka vazhduar të përforcohet edhe në vitin 2024, duke reflektuar përkushtimin e Doganës për maksimizimin e të hyrave. Faktorët që kanë ndikuar në këtë sukses përfshijnë: përmirësimin e procedurave doganore, luftën kundër kontrabandës, rritjen e transparencës etj.

Me këtë rast, Dogana e Kosovës ka thënë se mbetet e angazhuar për t'i vazhduar kontrollet rigorozë dhe bashkëpunimin me autoritetet kompetente për ta mbrojtur ekonominë dhe sigurinë e vendit. Ky institucion i ka inkurajuar qytetarët ta raportojnë çdo veprim të dyshimtë apo të paligjshëm përmes numrit pa pagesë 0800 50095 për ta ruajtur integritetin dhe transparencën e shërbimeve të saj.



INDEP: Kosova po përballet me varfëri energjetike

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) ka organizuar të mërkurën tryezën me temën "Varfëria energjetike dhe tranzicioni i drejtë në Kosovë", ku janë paraqitur edhe disa rekomandime. Burim Ejupi, drejtor ekzekutiv në INDEP, ka theksuar se këto rekomandime do të jenë shtesë për të avokuar këto politika në të ardhmen. "Për neve këto rekomandime do të jetë shtesë për të avokuar këto politika për vitet që vijnë. Është hera e parë që merremi me energji elektrike. Si shoqëri civile kemi pozicion më të mirë me e zënë politikën



në fushatë", ka thënë Ejupi. Ndërsa Naim Bujupi, hulumtues i lartë në INDEP, ka thënë se varfëria e energjisë

është një problem i vazhdueshëm në të gjithë Evropën, e sidomos në Kosovë. Sipas statistikave, Bujupi ka

theksuar se në vitin 2022 mbi 41 milionë njerëz në BE janë në varfëri të energjisë, ndërsa 7 për qind kanë borxhe të faturave. "Ky raport ka qenë sfidë për mua duke i analizuar të gjitha elementet në sektorin e energjisë. Në diskursin publik bisedojmë në tranzicionin e energjisë, por asnjëherë se çfarë impakti ka. Në Kosovë është diskutuar për nivelin social, por varfëria energjetike është shumë më shumë. Ende nuk ekziston një definicion i qartë në vendin tonë. Nëse do të ishte diçka e tillë vetë institucionet do ta ulnin varfërinë energjetike. Varfëria e energjisë

prek familjet me të ardhura të ulëta. Faktorët janë të ardhurat e ulëta, kosto të larta të energjisë dhe eficaenca e dobët e energjisë në ndërtesa. Rreth 40 milionë në Evropë janë në varfëri të energjisë, apo 9.3 për qind e popullsisë, ndërsa afërsisht 7 për qind kishin borxhe në faturat e shërbimeve për energji. Masat përfshijnë mbështetje të synuar për familjet e cenueshme, skemat e rinovueshme dhe përpjekjet për t'i ulur faturat e energjisë, duke siguruar që askush të mos mbetet prapa në ndryshimin drejt një ekonomie neutrale për klimën", ka thënë Bujupi.

Murati: Në pjesën e parë të vitit 2024 ekonomia është rritur për 4.9 për qind

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka paraqitur buxhetin për vitin 2025 para anëtarëve të Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere. Murati ka treguar se buxheti për vitin e ardhshëm arrin vlerën e 3.6 miliard eurove. "Buxheti për vitin e ardhshëm parashihet të jetë 3.6 miliardë eurosh, ndërkaq ky buxhet parashihet të financohet nga të hyrat buxhetore në nivelin e 3 miliardë e 305 milionë euro, kurse pjesa tjetër prej 300 milionë eurosh do të jetë nga deficitin buxhetor. Për të ardhur deri të ky buxhet janë

marrë parametrat e zhvillimit ekonomik dhe performancës së vitit aktual. Inflacioni deri në shtator ka shënuar 1.9 për qind", ka thënë Murati. Më tutje, Murati ka thënë se, pavarësisht krizës globale, Kosova ka shënuar rritje ekonomike. "Pavarësisht prej përballjes së situatës së vështirë në nivel global, rritja ekonomike ka shënuar performancë të mirë gjatë këtij viti. Në pjesën e parë të vitit 2024 ekonomia është zgjeruar 4.9 për qind. Deri në fund të vitit presim që ekonomia të zgjerohet 6.6 për qind në terma nominalë", ka theksuar



Murati. Kritika për këtë buxhet kanë adresuar partitë opozitare.

Deputeti i PDK-së, Mërgim Lushtaku, ka thënë se qytetarët janë duke u përballur me rritjen

e çmimeve. "Rritja e buxhetit për vitin e ardhshëm nuk paraqet ndonjë risi sidomos për shkak të rritjes së çmimeve, ku qytetarët po përballen çdo ditë. Nuk është lajm kjo rritje, marrë parasysh gjendjen në të cilën gjenden bizneset e sidomos për shkak të rritjes së tatimit në pronë", ka thënë Lushtaku. Pas diskutimeve, me pesë vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere ka votuar buxhetin e shtetit për vitin 2025, i cili është përcjell për miratim në seancë plenare të Kuvendit.

Raporti i FMN-së për Evropën, Ismaili: Sistemi financiar në Kosovë mbetet i qëndrueshëm

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Departamenti për Evropën i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), në bashkëpunim me Bankën Qendrore të Kosovës (BQK), ka paraqitur në Prishtinë raportin mbi perspektivën ekonomike rajonale të Evropës (REO). Në këtë ngjarje kanë marrë pjesë mbi 60 përfaqësues nga institucionet dhe organizatat të ndryshme, duke përfshirë sektorin publik, atë akademik, sektorin financiar dhe organizatat ndërkombëtare.

Prezantimi ka ofruar një pikëpamje të zhvillimeve të fundit ekonomike dhe perspektivës së Evropës duke diskutuar se si zgjerimi i mëtejshëm drejt BE-së mund të mbështesë më tej integrimin dhe ta përshpejtojë përafrimin e vendeve që aspirojnë anëtarësimin në BE. Guvernatori i BQK-së, Ahmet Ismaili, ka theksuar se sistemi financiar i Kosovës mbetet i qëndrueshëm, me likuiditet të lartë dhe i mirë kapitalizuar. Ai ka vënë në pah angazhimin e vazhdueshëm të BQK-së për

reforma dhe harmonizimin e kornizës ligjore me standardet e BE-së, duke shprehur mirënjohjen për mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë. "Duke ruajtur një sektor bankar të rregulluar mirë dhe duke monitoruar nga afër treguesit kryesorë financiarë dhe makroekonomikë, ne mund t'i përballojmë pasiguritë dhe të punojmë drejt një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik. Reformat tona synojnë forcimin e sektorit bankar dhe integrimin e tij drejt BE-së", ka thënë Ismaili.



Një vepër e vlefshme për procesin e krijimit të shtetit shqiptar dhe për rolin e shqiptarëve në rënien e Perandorisë Osmane

– Recension për librin e fundit të Daut Dautit, botuar nga shtëpia e njohur botuese, Bloomsbury Academic –

Nga: **Andrew Thomas PARK**, studiues dhe profesor në Universitetin e Hong-Kongut / *Revista Journal of British Studies* (2024), 1-2, botuar nga Cambridge University Press.

Libri i Daut Dautit, Britania dhe çështja shqiptare gjatë rënies së Perandorisë Osmane, 1876-1914 [Britain, the Albanian Question and the Fall of the Ottoman Empire, 1876-1914], gjurmon marrëdhëniet dhe perceptimet e ndërsjella midis elitës politike britanike dhe lëvizjes së sapolindur nacionaliste shqiptare, gjatë katër dekadave që çuan në krijimin e shtetit shqiptar. Nëse për pjesën më të madhe të kësaj periudhe këto marrëdhënie ishin kryesisht të heshtura, për një moment të shkurtër – por, vendimtar, gjatë Konferencës së Ambasadorëve në Londër më 1912-’13 – Britania luajti një rol vendimtar. Libri i Dautit ofron një sfond të dobishëm për këto zhvillime, duke u thelluar më herët në kohë sesa studimet e tjera në gjuhën angleze mbi krijimin e shtetit shqiptar dhe duke përdorur burime në gjuhën shqipe dhe nga arkivat ish-osmane.

Në libër, Dauti ndjek kryesisht një strukturë kronologjike. Pavarësisht periudhës së përmendur në titull, kapitulli i parë fillon në fund të shekullit të tetëmbëdhjetë me përshkrimet e para për Shqipërinë të botuara në Britani – kryesisht nga shkrimtarë udhëpërshkrues, ku më i njohuri ishte poeti Lord Bajron [Byron]. Një tjetër shkrimtar interesant që udhëtoi në rajon ishte Benjamin Disraeli, i cili e vizitoi Shqipërinë në vitin 1830, pak pas rimarrjes së kontrollit në vend nga osmanët, duke masakruar qindra krerë shqiptarë që kishin mbështetur grekët në kryengritjen e tyre të mëparshme.


Përshkrimi pozitiv i shqiptarëve nga Bajroni dhe Disraeli bazohet në pikëpamjet e tyre laike, një perspektivë që kundërshtohet nga liberalizmi kristiano-centrik i William Gladstoneit. Qëndrimet britanike ndaj Shqipërisë, argumenton libri, u skalitën kryesisht nga pozicionet konservatore dhe liberale që përfaqësonin Disraeli dhe Gladstone. Megjithatë, kjo nuk sollti ndryshime të prekshme në

rezultatet politike për shqiptarët.

Kapitulli 2 e ilustron këtë duke vënë në dukje se, pavarësisht qëndrimit të përzemërt të Disraelit gjatë Kongresit të Berlinit më 1878 dhe më pas – sekretari i tij i Jashtëm, Lord Salisbury, u takua me një delegacion të Lidhjes Shqiptare, të trupit të parë (jetëshkurtër) të organizuar të unitetit politik shqiptar – ai në fund “nuk iu përgjigj kërkesës së tyre” (37). Konservatorët i shihnin shqiptarët si një mburojë mbështetëse të Perandorisë Osmane, ndërsa, për të njëjtën arsye, liberalët i shihnin ata si myslimanë të padenjë për mbështetjen që ata ua jepnin popullsisë të krishtera të Perandorisë Osmane. Kapitulli 3 shqyrton këto perceptime konkurruese teksa vepronin brenda Komitetit Ballkanik – një grup presioni për politikën e jashtme, i themeluar më 1903 dhe që mbështeste autonominë e Maqedonisë Osmane, por që kryesisht e shihte rajonin “përmes prizmit të fesë” dhe për këtë arsye prirej të anashkalonte rolin e shqiptarëve (56).

Shqipëria ishte, sigurisht, gjithmonë pjesë integrale e çështjes maqedonase dhe e fatit më të gjerë të Perandorisë Osmane në Evropë. Kapitujt 4-6 e përshkruajnë këtë dhe kështu nxjerrin në pah edhe rolin e Britanisë në lëvizjen kombëtare shqiptare. Shoqëria Britanike dhe e Huaj Biblike luajti një rol të rëndësishëm që nga mesi i shekullit të nëntëmbëdhjetë në përkthimin dhe shpërndarjen e Dhiatës së Re në gjuhën shqipe, e cila, siç shkruan Dauti, ishte “popullore thjesht sepse ishte një libër në shqip” (88). Britania luajti gjithashtu një rol në planet politike të politikanëve kryengritës shqiptarë. Kur ishte ende besnik ndaj osmanëve dhe jo ende themelues i Shqipërisë moderne, Ismail Bej Qemali i dërgoi sulltanit një memorandum në vitin 1892, duke kërkuar një federatë ballkanike dhe një antantë me Britaninë për të zmbrazur Rusinë.

Në fund, pas Revolucionit të Xhonturqve të vitit 1908, të cilin Dauti e riformulon mirë në lidhje me rolin e rëndësishëm të luajtur nga Shqipëria, qeveria osmane do të orientonte veten drejt Gjermanisë. Ai vëren se si politika e gjuhës shpejt prishi



mbështetjen e mëparshme të shqiptarëve me xhonturqit, gjë që përfundimisht çoi në armiqësi të hapur dhe pasoja më të gjera. Megjithatë, çështja e gjuhës ndihet gjithashtu në një mënyrë tjetër. Ndërsa shkrimi i Dautit është kryesisht i qartë, ka disa idiosinkrazi, zgjidhja e të cilave mund të kishte ndihmuar lexuesin. Ndërsa kryengritja shqiptare e vitit 1911 dështoi, ajo arriti të nxiste Britaninë të mbështeste autonominë shqiptare, gjë që Dauti e përshkruan si “një hap vendimtar në braktisjen, nga qeveria britanike, të politikës miqësore ndaj Portës” (106). Kryengritësit shqiptarë patën më shumë sukses në vitin 1912, por mundësia e autonomisë shqiptare shqetësoi shtetet fqinje ballkanike dhe kjo kontribuoi në shpërthimin e Luftërave Ballkanike. Lindja e Shqipërisë gjatë Konferencës së Ambasadorëve në vitet 1912-’13, u ndihmua nga Sir Edward Grey, i cili tani e shihte më së miri shërbimin ndaj interesit britanik duke avokuar për një shtet të ri.

Diskutimi i Dautit mbi këtë diplomaci është disi i

përmbledhur dhe është më mirë i shpjeguar në librin Lindja e Shqipërisë [The Birth of Albania, 2012] nga Nicola Guy dhe në studimin klasik të Ernst Helmreichut të vitit 1938. Po ashtu, argumenti si i tërë mund të kishte përfituar nga një angazhim më i thellë në kontekstin më të gjerë ndërkombëtar, i cili ndonjëherë humbet për shkak të përqendrimit të ngushtë të Britania. Megjithatë, libri i Dautit nuk është një histori e ngushtë diplomatike, por një përpjekje për të ilustruar lidhjen midis perceptimeve të brendshme britanike dhe rezultateve politike.

Kapitujt 7 dhe 8, dy të fundit të librit, pasqyrojnë këtë, pasi shqyrtojnë karrierat e dy mbështetësve të shquar britanikë të çështjes shqiptare, të cilët ndihmuan në formësimin e opinionit publik gjatë kësaj periudhe. Edith Durham dhe Aubrey Herbert ishin të dy anëtarë të pakënaqur të Komitetit të Ballkanit, të cilët u zemëruan nga injorimi i çështjes shqiptare nga ky komitet. Herberti krijoi Komitetin Shqiptar për ta

kundërshtuar këtë qëndrim, por ndikimi përfundimtar i përpjekjeve të tij publike është i vështirë për t’u gjykuar. Komiteti kritikoi rezultatin e Konferencës së Londrës, por vetë Herberti lavdëroi Grey. Duket se Durhami pati më shumë sukses duke ndikuar të diplomatët britanikë – nga terreni në Ballkan. Megjithatë, pasi u largua nga Shqipëria në vitin 1914, ajo u kthye vetëm një herë, shtatë vjet më vonë – dhe mbeti e zhgënjyer, duke shkruar, siç e citon Dauti: “[Nuk] ndej se Shqipëria ime ekzistonte më” (134). A mund të kishte ekzistuar vërtet ndonjëherë Shqipëria e imagjinuar nga ndonjëri prej britanikëve që trajtohen në këtë libër?

Cilado qoftë përgjigja për këtë pyetje, në eksplorimin e perceptimeve të brendshme britanike, Dauti ofron një sfond të vlefshëm për procesin e krijimit të shtetit shqiptar, i cili përfundimisht u realizua. Në këtë mënyrë, Dauti gjithashtu arrin të rikthejë rëndësinë e Shqipërisë në historinë e rënies dhe shpërbërjes së Perandorisë Osmane. /Telegrafi/



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Vazhdon shkëlqimi i Zhegrovës, Juventusit mendon ta ketë në radhët e veta



“Epoka e re”

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Edon Zhegrova është padyshim lojtari shqiptar më në formë momentalisht. Ylli i Përfaqësueses së Kosovës ka shkëlqyer edhe në ndeshjen e fundit kundër Juventusit, duke dhuruar një asistim maestral, të cilin më pas në gol e shndërroi Jonathan David. Ndeshja në mes të Juventusit dhe francezëve të Lille përfundoi 1-1, e vlefshme për Ligën e Kampionëve. Kjo paraqitje dhe paraqitjet e tjera kanë rënë në sytë e bordit të “Zonjës së Vjetër” që e do futbollistin “dardan” në radhët e veta, raporton “Fichajes”. 25-

vjeçari këtë sezon e ka ngritur nivelin e lojës duke qenë ndër më të mirët në skuadrën e Lille ashtu edhe në Përfaqësuesen e Kosovës dhe kjo ka bërë që edhe klube të tjera të mëdha evropiane të shfaqin interesim për shërbimet e tij. Interesimi i Juventusit nxitet nga nevoja e klubit për të gjetur emra të rinj për ta freskuar sulmin e tyre, veçanërisht pasi u përballen me Lillen dhe dëshmoi drejtpërdrejt ndikimin e Zhegrovës. Interesimi i Juventusit nxitet nga nevoja e klubit për të gjetur emra të rinj për ta freskuar sulmin, veçanërisht pasi u përball me Lillen dhe dëshmoi drejtpërdrejt ndikimin e Zhegrovës. Muajt në vazhdim do

të jenë vendimtarë për të ardhmen e Zhegrovës, i cili që në janar mund të transferohet në Serinë A, duke e bërë kështu hapin e madh në karrierën e futbollit. Për asistimin e Zhegrovës ndaj Juventusit ka shkruar edhe faqja zyrtare e Ligës së Kampionëve në “Twitter”, ku e ka lavdëruar këtë asistim. “Shkëlqimi dhe vizioni i Zhegrovës”, shkruhej në postimin që përmban tri asistimet më të mira të ndeshjeve të së martës në garën më prestigjioze evropiane për klube. Ish-futbollisti i Prishtinës ka luajtur edhe për Genkun dhe Baselin, kurse për Kosovën ka luajtur 40 ndeshje dhe ka realizuar pesë gola.

SHKURT

Krasniqi dhe Humolli-Jashanica diskutojnë për sportin e kajakimit

Presidenti i Komitetit Olimpik të Kosovës, Ismet Krasniqi, ka pritur në takim drejtoreshën për Kulturë, Rini dhe Sport në komunën e Podujevës, Vlora Humolli - Jashanica. Palët kanë diskutuar për mundësinë e bashkëpunimit ndërmjet KOK-ut dhe komunës së Podujevës në interes të zhvillimit të mëtejshëm të sportit në këtë komunë. Biseda u fokusua edhe në projektin e Federatës së Kajakimit të Kosovës, për të pasur një qendër të kajakimit në Liqenin e Batllavës, aty ku zhvillojnë kryesisht aktivitetin e tyre, projekt ky që do t'i shërbente edhe komunitetit sportiv të Podujevës dhe më gjerë.

Evertoni: Mrekulli që ta shohim në stërvitje Armando

Armando Broja rikthehet në stërvitje pas lëndimit që e la jashtë fushës së blertë prej muajit gusht. Vetë klubi i Evertonit ka postuar një foto në rrjetet sociale. “Mrekulli që ta shohim në stërvitje Armando”, është mesazhi mbi foton e sulmuesit shqiptar. 23-vjeçari duket i qeshur, teksa londinezët shpresojnë ta kenë sa më shpejt ta gatshëm në fushë. Kujtojmë se Evertoni e huazoi Brojën nga Chelsea në fillimin e sezonit. Broja pritet të mungojë edhe në dy ndeshjet e muajit nëntor të Kombëtares së Shqipërisë kundër Çekisë dhe Ukrainës në “Air Albania”.

Trepça pëson humbje në Gjermani

Kampionia e Kosovës, Trepça, ka pësuar nga MHP RIESEN Ludwigsburg me rezultat 87:54 (15:11, 25:13, 25:16, 22:14). Takimi u zhvillua në kuadër të javës së pestë të grupeve në FIBA Europe Cup. Mitrovicasit e nisën ndeshjen më mirë me një seri 0:6, të përkratur edhe nga tifozët shqiptarë në Gjermani, por më pas skuadra gjermane e mori lojën në duar dhe e kontrolloi deri në fund, për të triumfuar 87:54. Për Trepçën u dalluan Larry Thomas me 21 pikë dhe Mikailë Tmusiq me 14. Mitrovicasit kanë pesë humbje në pesë ndeshje të zhvilluara. Takimin e fundit Trepça e zhvillon ndaj Caledonia më 13 nëntor.

Kosova U17 kualifikohet në Ligën A, kundërshtarët i mëson në dhjetor

Përfaqësuesja e Kosovës e vajzave U17 është kualifikuar në Ligën A për kualifikimet e Evropianit, pasi e ka mbyllur turneun kualifikues të Grupit B4 në pozitën e parë, me 4 pikë. Kalimi në Ligën A u konfirmua sot, pasi Shqipëria shënoi fitore në duel me Izraelin, në ndeshjen e fundit të grupit, me rezultat 2:1. Të rikujtojmë se dardanet U17 shënuan fitore ndaj Shqipërisë, në ndeshjen e parë 3:1, derisa më pas barazuan me Izraelin 1:1. E epillogut të ndeshjes Shqipëri - Izrael iu gëzua edhe përzgjedhësja e Kombëtares U17, Sanije Krasniqi, e cila së bashku me stafin e saj për të tretin vit radhazi me këtë kombëtare arrin të kualifikohet në Ligën A. Shorti për Ligën A për kualifikimet e Evropianit 2025 do të tërhiqet në dhjetor, derisa ndeshjet e fazës së ardhshme do të zhvillohen në pranverën e ardhshme.

Qeveria aprovon projektet kapitale për katër stadiumet e futbollit

PRISHTINË, 6 NËNTOR - Qeveria e Kosovës ka aprovuar katër projekte madhore të infrastrukturës sportive, përkatësisht ndërtimit dhe renovimit të stadiumeve në Pejë,

Prizren, Ferizaj dhe Vushtri si dhe renovimin e Galerisë Kombëtare. Një vendim të tillë ekzekutivi i vendit e ka marrë të mërkurën në një mbledhje elektronike. “Qeveria e Republikës së Kosovës

ka mbajtur mbledhje elektronike në të cilën ka aprovuar projektet kapitale shumë-vjeçare si në vijim: Ndërtimi i Stadiumit të Qytetit në Pejë; Renovimi i Stadiumit ‘Përparim Thaçi’ në

Prizren; Ndërtimi i Stadiumit të Qytetit në Ferizaj; Renovimi i Stadiumit të Qytetit në Vushtri dhe renovimi i Galerisë Kombëtare”, thuhet në njoftimin e qeverisë.



Probleme shëndetësore për trajnerin legjendar të NBA-s, bota e basketbollit lutet për Gregg Popovich

SAN ANTONIO, 6 NËNTOR - Gjendja shëndetësore e trajnerit legjendar të NBA-s, Gregg Popovich, po i shqetëson të gjithë fansat e basketbollit amerikan. Drejtuesit e San Antonio Spurs preferojnë, duke respektuar privatësinë e trajnerit 75-vjeçar, të mos hyjnë në detaje.

Trajneri nuk ishte në stol edhe në ndeshjen e fundit ndaj Minnesota për shkak të asaj që u përkufizua vetëm si një "problem mjekësor". Nuk ka mbërritur ende një buletin i vërtetë mjekësor, por sigurisht që nuk është një sëmundje sezonale, por diçka më serioze. Trajneri legjendar i

San Antonios për herë të fundit ka dalë në media pas humbjes ndaj Washingtonit, por u largua nga konferenca për shtyp. Vendin e tij te skuadra teksane e ka zënë ndihmësi i tij Mitch Johnson. Ai do të qëndrojë në krye deri në rikthimin e trajnerit legjendar të aftë. Gregg

Popovich ka fituar mbi 1 390 ndeshje dhe pesë tituj kampionë si trajner në NBA. Ditët në vijim Spurs do të japë informacione për gjendjen shëndetësore të Pop, por e gjithë bota e NBA-s po i mban gishtat e kryqëzuar me shpresën për të parë Gregg Popovich përsëri në detyrë.



Fonseca: Më e vështirë të luash kundër Monzas. Ancelotti: Ekipi nuk po jep më të mirën

MADRID, 6 NËNTOR - Në dy momente kyçe të sezonit, në derbin kundër Interit në Serinë A dhe në Ligën e Kampionëve kundër Real Madridit, Milani i tij zhvilloi dy super sfida duke dalë triumfues, dy suksese të rëndësishme që largojnë "hijet" mbi trajnerin Fonseca. Tekniku portugez nuk e fshehu gëzimin pas fitores në "Bernabeu", duke zbuluar dhe recetën e suksesit: "Fituam pasi lojtarët luajtën me guxim, erdhën këtu pa pasur frikë nga askush. U treguam të zotë që mbajtëm topin në këmbë, më pas të kujdesshëm duke i goditur në momentin e duhur. Ndeshjet evropiane janë të ndërlikuara, janë shumë ndryshe nga ato të Serisë A. Është më e vështirë të luash kundër Monzas e Cagliariarit sesa kundër Realit. Tani duhet të vazhdojmë të rritemi", u shpreh Fonseca. I ndryshëm është diskutimi në Spanjë, ku të gjithë në radhët e



Realit, nga trajneri Carlo Ancelotti deri te lojtarët, kanë përfunduar nën akuzë pas një ecurie shumë negative. "Nuk kishte asnjë reagim pas asaj ndeshje kundër Barcelonës. Shpesh ishim të zbalancuar. Nuk arrinim ta rikuperonim topin. Duhet të jemi të përgatitur pasi ekipi nuk po jep më të mirën. Duhet ta nisim nga

poshtë pasi ndeshjet tani ndërlikohen. Milani tregoi epërsi në duelet një kundër një, ndërsa ne u treguan të lehtë, joefikas", ka deklaruar Ancelotti. 6 pikë në 4 ndeshje janë shifra që nuk i shkojnë përshtat një ekipi si Real Madrid, ndërsa kjo fitore e dërgon Milanin në të njëjtën kuotë pikësh.

Alonso: Nga humbja e thellë nuk e shijova pritjen në 'Anfield', por s'është fundi i botës

LEVERKUSEN, 6 NËNTOR - Xabi Alonso, trajner i Bayer Leverkusenit, pas disfatës së pësuar ndaj Liverpoolit në "Anfield", ka thënë: "Mund të them shumë gjëra dhe t'u shpjegoj shumë gjëra lojtarëve, por ta kontrolloj atmosferën që krijohet në këtë stadium.... Unë e njoh situatën, e di që lojtarët vendas e ndiejnë atë. Nuk është e lehtë të mbrohemi, por në fund është e vështirë, nuk janë të lumtur, por nuk është fundi i botës". Trajneri spanjoll që ka luajtur për një kohë të gjatë për Liverpoolin ka thënë se është pritur mirë në "Anfield". "Do të jetë më e vështirë për të fjetur, por pastaj do të mendojmë për ditën tjetër. Më pritën mirë, kam



ndjenja të hidhura për ndeshjen, që do të thotë se nuk mund ta shijoj pritjen. E kam vlerësuar shumë, jam mirënjohës që pas kaq vitesh kam ende një lidhje me klubin, por do të ishte edhe më mirë me një rezultat më të mirë", ka shtuar ai. Duke folur për rezultatin e ndeshjes, Alonso ka potencuar se pjesa e dytë ishte më e vështirë për skuadrën e tij.

"Sigurisht, pjesa e dytë nuk ishte mjaft e mirë në krahasim me të parën. Në 45 minutat e para ne konkurruam shumë mirë dhe luajtëm mirë. Arritëm të kishim posedim të mirë të topit dhe ndoshta nuk patëm shumë raste, por ishim intensivë në mbrojtje dhe kishim organizim të mirë. Në pjesën e dytë filluam të mos e kishim topin, nuk mund ta gjenim lojtarin e lirë. Goli i parë ishte pasojë e kësaj. Ata e kaluan topin shumë lehtë. Ne nuk ishim mjaftueshëm të shpejtë dhe goli i dytë dy minuta më vonë... Humbja 4-0 është një rezultat i vështirë, më i vështirë për t'u pranuar se performanca, por kjo është Liga e Kampionëve në 'Anfield', ka deklaruar Alonso.

SHKURT

Milevski fton gjashtë shqiptarë, ftesa e parë për Behar Fetahin

Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Maqedonisë së Veriut, Bllagoja Milevski, ka shpallur listën e lojtarëve të thirrur për ndeshjet kundër Letonisë (14 nëntor) dhe Ishujt Faroe (17 nëntor) në kuadër të Ligës së Kombeve. Të dyja ndeshjet do të luhen në Arenën "Todor Proeski" në Shkup. Pas katër xhirove në grupin e Ligës së Kombeve, përfaqësuesja e Maqedonisë së Veriut është në vendin e parë me 10 pikë të fituara. Risi në formacion është Behar Fetahi, i cili luan te Domzhale. Ai ka marrë ftesë për herë të parë në ekipin e të seznioreve, deri më tani ka luajtur vetëm për përfaqësuesen U21. Në listën e Milevskit, përveç Fetahit, janë edhe Sefer Emini dhe Lirim Qamili të cilët po kalojnë një formë të mrekullueshme në kampionatin e Danimarkës, pastaj është Visar Musliu, Isnik Alimi, Ezgjan Alioski dhe kapiteni Enis Bardhi.

Dy futbollistët e Cityt, më të paguarit në Premierë Ligë

Lojtari që paguhet më shumë në Premierë Ligë është mesfushori belg Kevin de Bruyne. Lojtari i Manchester Cityt paguhet 24.79 milionë euro në vit. Në vendin e dytë të renditjes ndodhet shoku i tij i skuadrës Erling Braut Haaland, me 23.24 milionë euro. Këto janë të dhënat e "Spotrac" për pagat e futbollistëve. Në vendin e tretë është mesfushori brazilian Casemiro, i cili arrin në 21.69 milionë euro në radhët e Manchester Unitedit. Ndërsa në vendin e katërt është Mohamed Salah (Liverpool), i cili fiton po aq sa braziliani. Në vendin e pestë është një futbollist anglez, Raheem Sterling i Chelsea, që mbyll "Top 5 më të paguarit" me një pagë vjetore prej 20.14 milionë eurosh.

Ylli i NBA-s suspendohet për tri ndeshje pas përplasjes me një gazetar

Qendra e Philadelphia 76ers, Joel Embiid, është pezulluar për tri ndeshje pasi shtyu një gazetar. Fituesi i Çmimit të Lojtarit Më të Vlefshëm të NBA-s për vitin 2023 shtyu një kolumnist të "Philadelphia Inquirer" pas një artikulli kritik që përmendte djalin dhe vëllanë e tij të ndjerë, si dhe kritikonte gjendjen e tij fizike dhe profesionalizmin. Incidenti ndodhi pas humbjes së 76ers me rezultatin 124-107 ndaj Memphis Grizzlies të shtunën. Embiid, shtatë herë pjesëmarrës në All-Star, nuk ka luajtur ende këtë sezon për shkak të një problemi në gju. "Nderimi i ndërsjellë është parësor në marrëdhëniet mes lojtarëve dhe medieve në NBA", ka thënë nënkryetari ekzekutiv dhe kreu i operacioneve të basketbollit në ligë, Joe Dumars, në një deklaratë. "Ndërsa e kuptojmë që Joel u ofendua nga natyra personale e versionit origjinal të artikullit, ndërveprimet duhet të mbeten profesionale në të dyja anët dhe asnjëherë nuk duhet të kthehen në përplasje fizike". Në mungesë të Embiid, Philadelphia ka fituar vetëm një nga gjashtë ndeshjet e para të sezonit.

City humbi 4-1, Guardiola: E vështirë ta shpjegoj

Manchester City ka humbur tri sfida radhazi, e fundit me rezultatin 4-1 në ndeshjen e zhvilluar në Lisbonë kundër Sportingut, e vlefshme për raundin e katërt në Champions

League. Viktor Gyokeres realizoi tripletë, duke befasuar "Qytetarët". Pep Guardiola këmbënguli pas ndeshjes se ekipi portugez nuk e dominoi ndeshjen pasi nuk bëri asgjë.

"Është e vështirë të shpjegohet kjo disfatë. Filluam shumë mirë, shënuam të parët dhe patëm një pjesë të parë shumë të mirë. Në futboll nuk mjafton vetëm të luash mirë. Duhet të shënosh

gola. Kur humbet 4:1, gjithçka që mund të bësh është ta përgëzosh Sportingun dhe ta marrësh si një mësim. Nuk ka vend për debate. Ata bënë dalje të mira me top nga mbrojtja në

sulm dhe shënuan gola të mrekullueshëm. Ne nuk ishim mjaftueshëm të ftohtë nën presion dhe të luajmë më mirë", ka thënë Guardiola për faqen zyrtare të UEFA-s.



Kompania Regionale e Mbeturinave KRM "Uniteti" Sh.A-Mitrovicë



Bazuar në dispozitat e nenit 21, nenit 25, par. 25.2, pika h, e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 31/2008 (dt. 15.06.2008), respektivisht nenit 13 të Ligjit nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 13/2021 (dt. 30.05.2012), dhe Ligjin nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, si dhe Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Komisioni i Auditimit të KRM "Uniteti", Sh.A – Mitrovicë, vendosi që të rishpallë këtë:

RISHPALLET KONKURS

Pozita: Auditor i Brendshëm.

I përgjegjës: Komisionit të Auditimit.

Vendi: Mitrovicë.

Paga: Në pajtim me politikën e kompensimit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.

Detyrat dhe Përgjegjësit:

• Udhëheqjen, menaxhimin dhe organizimin e brendshëm të Zyrës së Auditimit;

• Përpilimi i procedurave të auditimit, gjegjësisht planit të auditimit të brendshëm për të gjitha transakcionet e NP, konform objektivave të kontrollit të brendshëm, politikave dhe procedurave të NP, të bazuara në Ligjin e aplikueshëm;

• Auditimi i planeve investive dhe financiare të NP, planit vjetor të biznesit dhe buxhetit vjetor;

• Auditimi i pasqyrës vjetore të bilancit dhe deklaratat e fitimeve dhe humbjeve si dhe deklaratat financiare që kërkohen me ligj;

• Vlerësimi objektiv dhe shfrytëzimi efektiv i burimeve të NP si dhe dhënia e rekomandimeve adekuate për Komisionin e Auditimit;

• Verifikimi i përshtatshmërisë dhe funksionimi i rregullt i sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim të garantojnë zbatimin nga NP, të gjitha Ligjeve të aplikueshme në Kosovë gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe t'i siguroj Komisionit të Auditimit çfarëdo vërejtje apo sugjerime të cilat konsiderohen të nevojshme;

• Verifikimi i rregullt i përshtatshmërisë dhe funksionimi i rregullt të sistemeve dhe procedurave të cilat kanë për qëllim të sigurojnë se librat dhe dokumentacioni i NP, duke përfshirë dokumentacionin financiar mbahet në përputhje me standardet e kontabilitetit dhe me Ligjin dhe që projekti deklaratat vjetore financiare të përgatiten në mënyrë të rregullt;

• Analiza e sistemeve dhe proceseve të biznesit dhe kontrolleve të ndërlydhura me to;

• Raportimi i rregullt para Komisionit të Auditimit dhe përbushja e çfarëdo detyre tjetër të përcaktuara nga Komisioni i Auditimit;

• Komisioni i Auditimit dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të njohur të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe po ashtu secili kandidatë duhet të përbushë të gjitha kushtet e pavarësisë ashtu sikurse parashihet në nenin 17.2 (d), (f), (j), (k), (l) të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

• Të ketë Diplomë universitare në ekonomi, juridik, administratë publike, financa publike, kontabilitet apo fusha të tjera të studimeve relevante për sektorin që do të auditohet;

• Së paku tri (3) vite përvojë pune profesionale në lëminë e Auditimit të Brendshëm, Kontrollës së Brendshme dhe/ apo Financave dhe Kontabilitetit;

• Të jetë i certifikuar si auditor i brendshëm nga institucionet e licencuara në vend ose jashtë tij;

Njohurit dhe shkathësitë profesionale

• Njohuri të qasjeve moderne në planifikim dhe kontrollë;

• Njohuri e Ligjeve, Rregullore dhe Udhëzimeve Administrative të aplikueshme;

• Shkathësi të komunikimit, planifikimit të punës dhe udhëheqjes të aktiviteteve të auditimit;

• Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;

• Shkathësi organizative në përcjelljen e zbatimit të rekomandimeve me qëllim të realizimit të tyre në kohë;

• Shkathësi kompjuterike në programet, Microsoft Word, Excel dhe Access;

• Njohja e gjuhës angleze është e preferueshme.

Kandidati/ja duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

• Aplikacionin,

• CV-në,

• Dëshminë e shkollimit

• Dëshminë për përvojën e punës,

• Certifikatën për Auditor të Brendshëm,

• Referencat, si dhe certifikatat tjera profesionale,

• Letër Motivimit,

• Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se 3 muaj).

• Kopja e dokumentit të identifikimit.

Dorëzimi i kërkesës dhe dokumentacionit përkatës bëhet në Arkivin e KRM "Uniteti" Sh.A në

Mitrovicë, me zarf të mbyllur me shënim: "Për pozitën e Auditor të Brendshëm". Konkursi zgjatë 30 ditë, dorëzimi i dokumenteve filon nga data 06.11.2024 dhe përfundon në ora 16.00 të datë 05.12.2024. Dokumentacionet e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacion përkatës, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Komisionit të Auditimit. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim, ndërsa KA mban të drejtën e formimit të listës së shkurtër me aplikant.



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë-Ministraskvo Pravde-Ministry of Justice



Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar / Agjencia za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom/ Agency for Administration of Sequestered and Confiscated Assets

Ftesë për Ankand Publik

Datë 06.11.2024

Referenca: AAPSK – 013/2024

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:

| Nr | Përshkrimi | Sasia/copë | Çmimi Fillestar/copë | Çmimi nga ofertuesi | Çmimi total € |
|----|---|-------------------|----------------------|---------------------|---------------|
| 1 | Audi A6 viti i prodhimit 2004, ngjyrë hiri-për pjesë Rishpallje | 1 copë/ për pjesë | 810.00 € | | |
| 2 | Furgon Mercedes- Benz Vario 814 D, viti i prodhimit 1999,dizel,ngjyre e bardhe, me targa te huaja Rishpallje | 1 copë | 3,600.00€ | | |
| 3 | Kamion Mercedes 814, viti i prodhimit 1990; dizel, ngjyrë e kaltër, me targa vendore | 1 copë | 3,500.00 € | | |
| 4 | VW Caddy 2.0,viti i prodhimit 2008 ,dizel, ngjyrë e bardhe-me targa të huaja | 1 copë | 2,700.00€ | | |
| 5 | VW Passat, dizel, ngjyrë e kaltër -për skrap | 1 copë/ për skrap | 325.45€ | | |
| 6 | Rimorkio Rolfo C171 viti i prodhimit 2010 | 1 copë për skrap | 2,439.50€ | | |
| 7 | VW Golf III viti i prodhimit 1994, dizel ngjyre Vishnje me targa vendore | 1 copë | 1,200.00€ | | |
| 8 | Suzuki FJ JIMNY viti i prodhimit 2001, benzin, shume ngjyrësh me targa vendore | 1 copë | 4,200.00€ | | |
| 9 | Audi 89 viti i prodhimit 1989 ngjyre e bardhe | 1 copë për skrap | 270.00€ | | |
| 10 | Motociklet YADEA L1-e-B ngjyre kuqe, | 1 copë për pjesë | 300.00€ | | |
| 11 | Suzuki Vitara viti i prodhimit 1989 ngjyrë e gjelbër, benzin- për skrap | 1 copë për skrap | 230.00€ | | |
| 12 | Furgon VW Transporter viti i prodhimit 1986 ngjyre e Kaltër, benzin- për skrap | 1 copë për skrap | 327.75€ | | |
| 13 | Audi 80 Quatro viti i prodhimit 1991 ngjyre e Kaltër, benzin- për skrap | 1 copë për skrap | 315.10€ | | |

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohet më së largu deri më **13.11.2024 në ora 11:00h, në lokalet e AAPSK-së, në adresën: Depo e Agjencisë Rr. Bajram Bahrini (ish Kazerma e FSK-se) fshati Llukur KK Prishtinë.**

Të interesuarit mallin mund ta shikojnë me datë: **13.11.2024**, prej orës 10:00-11:00 në **Depon e Agjencisë në fshatin Llukur KK Prishtinë.**

Pasurit e sekuestruar ose të konfiskuara në këtë procedurë shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr. 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-se në: <https://aaprk.gov.net> apo <https://md.rks.gov.net/> Në zarf të shkruhet për: AAPSK, Sektori i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 11:00. Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 67 254



Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës
The Trade Union Health Federation of Kosova
Sindikalna Federacija Zdravstva Kosova

Bazuar në nenin 21 paragrafi 3 i Ligjit nr. 04/L-011 gjeni më poshtë informacionet dhe kërkesat për shërbimin në lidhje me auditimin e jashtëm të xhirologarisë kryesore të FSSHK-së si dhe për xhirologaritë e Regjioneve Sindikale, Sindikatën e QKUK-së, Shoqata Sindikale e Punëtorëve Shëndetësor të QKUK-së, Sindikatën e IKSHPK, Sindikatën e EKTGJ, Sindikatën e Stomatologjisë dhe Sindikatën e IML-së.

| | |
|--|--|
| Organizata: | FSSHK |
| Tipi i Shërbimit të kërkuar: | Auditimi i jashtëm për vitin 2023, 2024 |
| Data e dorëzimit të ofertës financiare dhe dokumentacionit: | 7 ditë pas publikimit në shtypin ditor. |

Informacion mbi FSSHK-në

Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës – është organizatë përfaqësuese e punëtorëve shëndetësor në Republikën e Kosovës, e që paraqet organizim sindikal në nivel Federate.

FSSHK-ja, me një strukturë të sofistikuar organizative, ofron përfaqësim dhe mbrojtje dinjtoze për të gjithë anëtarët e saj, dhe ka të shtrirë strukturën e saj në mbarë territorin e Republikës së Kosovës. Selia e FSSHK-së gjendet në kryeqytetin e Kosovës, dhe ka të punësuar stafin profesional, përmes të cilit jep ndihmë profesionale për mbarë anëtarësinë e saj.

FSSHK-ja, si organizatë e pavarur dhe e orijentuar në interesa të veçanta mbi mbrojtjen e të drejtave dhe dinjitetit të punëtorëve shëndetësorë, e organizuar sipas parimeve moderne demokratike, dhe funksionalitet të realizuar përmes organeve vendimmarrëse mbi bazën e vullnetit të anëtarësisë, paraqet asociimin e punëtorëve shëndetësorë në arritjen e qëllimeve të materializuara në harmoni me kërkesat reale të tyre.

Shërbimi i kërkuar

- Auditimi i jashtëm i mjeteve të shpenzuara për vitin fiskal 2023, 2024 të përgatitura sipas Standarteve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe rregullave të tjera në fuqi në Kosovë.
- Raporti i Auditimit kërkohet të paraqitet në gjuhën Shqipe.

Dokumentacioni që duhet të paraqitet nga Aplikantët

- Licenca e Praktikes se Firmës Ligjore të Auditimit;
- Certifikata e Regjistrimit të Biznesit; numrit fiskal; TVSH-së (nëse jeni deklarues i TVSH-së);
- Historikun e firmës ligjore dhe CV e drejtuesit të saj.
- Do të preferohen firmat e auditimit të cilat kanë së paku 2 vite eksperiencë në auditimin e veprimtarive përkatëse.
- Plani i Punës së Procesit të Auditimit.


Ju lutemi të sillni ofertën financiare së bashku me dokumentacionin e lartpërmendur, jo më vonë se 7 ditë pas publikimit në shtypin ditor, me email ne adresen info@fshk.eu ose me postë.

Adresa e Kontaktit:

FSSHK- Rr. Mustaf Kruja V/17-Prishtinë
e-mail: info@fshk.eu
tel: 048/588-902

Kompania Rajonale e Mbeturinave
Regionale Komitete të Ushtrimit Qendror

PASTRIMI a.s. a.s.d.
Nbr. 6719/11 dt. 06.11.2024
Prishtinë - Prishtinë



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE " PASTRIMI" SILA

Njoftim për vazhdim të afatit të konkursit

KRM "Pastrimi" më datën 19/10/2024 ka hapur konkursin për pozitën Zyrtarë/e për menaxhimin e rrjeteve sociale dhe është mbyllur në datën 04/11/2024.

KRM "Pastrimi" vazhdon afatin e konkursit publik për pozitën Zyrtarë/e për menaxhimin e rrjeteve sociale nga data 06/11/2024 deri në datën 10/11/2024, ora 16:00.

Udhëzimet për aplikim mund t'i gjeni në konkursin bazë të publikuar në gazetë, në datën 19/10/2024.

Obaveštenje o produženju konkursnog roka

RPO „Pastrimi“ je 19/11/2024. godine otvorio konkurs za poziciju Službenik za upravljanje društvenim mrežama i isti je zatvoren 04/11/2024.

RPO „Pastrimi“ nastavlja rok za raspisivanje javnog konkursa za funkciju Službenik za upravljanje društvenim mrežama od 06/11/2024 do 10/11/2024, 16:00 sata.

Uputstvo za prijavu možete pronaći u osnovnom konkursu objavljenom u novinama 19/10/2024.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT




SWISS

TAVERNA




Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553


PRISHTINË





Lume's Details


Estetik & Depilim



 044 900 978 | 045 681 898

 Sallon Depilimi Lume's Details

 lumesdetails

 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Genc Bujar Baftiu shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e Gjimnazit "Naim Frashëri" Prishtinë.
- Kushtrim Halili, shpall të pavlefshme dëftesat e sh.m.l.e. "Hasan Prishtina".
- "Ulpiana Consulting" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 81185363.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Shqiprim Neziri nga Junik shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Kuvendi i Junikut" Junik.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Gentiana Spahija nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e maturës të Gjimnazit "Hjadar Dushi" Gjakovë.
- Lëshohet banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Anita Stuja nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit, dëftesat e kl. 10.11.12 dhe certifikatën e maturës të Gjimnazit "Hjadar Dushi" Gjakovë.
- Faton Kastrati Vermicë, K.K Malishevë shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3. dhe diplomën e sh.m.t. "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.
- Shqipe Goranci nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.e. "Kadri Kusari" Gjakovë.
- Lëshohet banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Haxhi Ukshini nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.m. "Hysni Zajmi" Gjakovë.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zuloi CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

